**VENDIM**
**Nr.229, datë 18.3.2020**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.586, DATË 30.8.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PUNËSIMIN E PËRKOHSHËM TË STUDENTËVE TË EKSELENCËS NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të kreut III, të vendimit nr.586, datë 30.8.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përjashtimisht për vitin 2020, afati i kontratës së lidhur për studentët e ekselencës të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas procedurave të thirrjes së parë të publikuar në janar 2019, shtyhet deri në përfundim të procedurave të rekrutimit në shërbimin civil, për këto pozicione pune.".

2. Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike dhe institucionet e administratës shtetërore, pjesë të fushës së veprimit të legjislacionit për nëpunësin civil, për zbatim e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**